



*VENDIM*

*Nr. 167, Datë 18.10.2016*

**PËR  
MIRATIMIN E RREGULLAVE TË ANKANDIT TË ZYRËS SË  
KOORDINUAR TË ANKANDEVE PËR EVROPËN JUGLINDORE  
(SEE CAO) VERSIONI 1.4**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 65 pika 1 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike, nenit 26 dhe 37 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, date 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 18.10.2016, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur dhe të rënë dakort nga (SEE CAO) dhe TSO-të aksionerë të saj, të Rregullave të Ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Europën Juglindore (SEE CAO) versioni 1.4, dhe relacionin përkatës,

**Konstatoi se:**

- Sekretariati i Energjisë (Vjene, Austri) dhe mbledhja 11-të e ECBR-së mbajtur me datë 09.07.2009, rekomandon që rregullatorët Kombëtarë të miratojnë rregulloret e aprovuara nga SEE CAO.
- Rregullorja është e hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores (KE) 714/2009 të Parlamentit Evropian.
- Shoqëria OST sh.a me shkresën Nr. 4855 Prot., date 25.08.2016 ka dërguar në ERE propozimin për miratim të Rregullave të Ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Europën Juglindore (SEE CAO) 1.4.
- Me vendimin nr. 153, datë 30.09.2016, Bordi i ERE-s filloi procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e rregullave të ankandit të zyrës së koordinuar të ankandeve për Evropën Juglindore SEE CAO (bashkëlidhur draft “Rregullat e ankandit, versionin 1.4).

- Per kete vendimmarrje u njoftuan palet e interesit si dhe u ftuan qe te shprehnin opinionet e tyre brenda dates 20.10.2016.
- OST me shkresen e saj nr 6358/1 fate 12.10.2016, mbeshtetur ne nenin 37 te “Rregullores se funksionimin dhe procedurave te ERE, miratuar me vendimin e bordit te ERE 96 date 17.06.2016, ka kerkuar pershpejtimin e procesit te vendimmarrjes nga Bordi i ERE me qellim qe kjo vendimmarrje te mos behet pengese per zhvillimin e ankandeve.
- Ndryshimet e kesaj rregulloreje nga versioni me heret i miratuar nga ERE CAO 1.3, jane te formes, pa cenuar permbajtjen, pra lidhen kryesisht me permiresime te gjuhës së shprehur të parashikimeve të kësaj rregullore.
- Autoriteti i Konkurrencës me herët me shkresën nr. Prot. 359/1, date 07.09.2015 ka bërë me dije se “Rregullorja” nuk bie ndesh me ligjin nr. 9171 date 28.07.2003 “Per mbrojtjen e konkurrences” i ndryshuar.
- Shqyrtimi i pershpejtuar i kësaj praktike nuk parashkruan asnjë të drejtë të palëve të interesuara për ta ankimuar vendimmarrjen e ERE.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të miratojë Rregullat e ankandit të zyrës së koordinuar të ankandeve për Evropën Juglindore **SEE CAO** Versioni 1.4 (bashkëlidhur “Rregullat e Ankandit, në gjuhën origjinale Angleze dhe ne shqip).
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë OST, MEI dhe palët e interesuara për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.